



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 3074 prot.

Shkodër, më 04.10 2021

Vendim

Nr. 301 datë 04.10.2021

PËR FINANCIMIN E BOTIMEVE DHE PJESËMARRJES NË KONFERENCA
SHKENCORE TË STAFIT AKADEMIK
TË UNIVERSITETIT TË SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI
Për vitin akademik 2020-2021"

Në mbështetje të Ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 3, shkronja "c", neni 38, pika 1, shkronja "k" në dhe Statutit të USH-së, me propozim të Rektorit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 04.10.2021

VENDOSI:

1. Të shpërndahej shuma e parashikuar në buxhet të zëri për botime dhe pjesëmarrje në konferenca të pedagogëve të USH-së në mënyrë të barabartë për çdo Njësi kryesore për vitin akademik 2020-2021.

- a) Këtë shumë pedagogët mund ta përdorin për pagesën e *fee-s* (tarifës) së konferencës dhe për botime.
- b) Kjo shumë nuk mund të shpenzohet më shumë se në masën 10% (dhjetë përqind) për konferenca ose botime brenda Shqipërisë (vetëm në ato te lista e revistave që Ministria e Arsimit dhe Sportit të Shqipërisë do të propozojë) ose në rajon (Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi). Shuma tjetër duhet të shpenzohet vetëm për konferenca ose botime në revista të BE-së dhe OECD-së. Përfshihen nga ky detyrim vetëm pedagogët që kryejnë veprimtarinë e tyre kërkimore-shkencore në fushën e Albanologjisë.
- c) Njësitë kryesore duhet të përdorin fondin për vitin akademik 2020-2021.
- d) Pedagogët nxisin marrëdhëniet e bashkëpunimit me kolegë dhe Universitete homologe.
- e) Kriteret e përfitimit të fondit:
- Të jenë pedagogë me kohë të plotë.
 - Të paguhet konferenca/botimi pavarësisht numrit të autorëve.
 - Të kenë informuar të paktën 1 (një) muaj para organizimit të konferencës (ose edhe më shpejt me qëllim pagesën e *fee-s*).
 - Të jenë të pranishëm në konferenca, të paktën brenda vendit.
 - Të paraqesin brenda 1 (një) muaji pas ardhjes së tyre një relacion të shkurtër mbi pjesëmarrjen e tyre në aktivitetin e zhvilluar.
 - Të deklarojnë (si 'Mirënjohje') në botim ose te prezantimi që financimi i tyre kryhet nga Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi".
 - Pedagogët që janë punësuar në vitin e fundit akademik përfitojnë vetëm 50% të shumës vitin e parë.
 - Të mos jenë pedagogë që vazhdojnë studimet e doktoratës jashtë shtetit dhe nuk janë të angazhuar me kohë të plotë në USH.
 - Të kenë gradën "Doktor i Shkencave" ose të jenë duke vazhduar studimet e doktoratës.
- f) Të tjera
- Nëse një Njësi kryesore nuk do që ta shpenzojë fondin për vitin akademik 2020-2021, por do që ta shpenzojë atë për vitin akademik 2021-2022 (psh. në një konferencë me *fee* të

lartë etj.) i jepet e drejta ta bëjë këtë vetëm nëqoftëse vë në dijeni, jo më vonë se data 30 tetor, Rektorin, Administratorin dhe Drejtorinë e Financës.

- Pagesat do të kryhen në bazë të Vendimit Nr 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, si dhe në bazë të Udhëzimit Nr.22, datë 10.07.2013 ‘Mbi zbatimin e vendimit nr.870, datë 14.12.2011 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”.

g) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Rektori, Administratori, Drejtoria e Financës.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Suzana GOLEMI



